



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

KONTRATË PËR FURNIZIM

KOMUNA E ISTOGUT në vazhdim Njësia e Prokurimit, të cilën e përfaqëson znj Zizë Bujupaj, menaxhere e Prokurimit, Rruga "Fadil Ferati" Nr. 121 në njërën anë; dhe

NT "RIMIDA" të cilën e përfaqëson, z. Rustem Hasani nga Llapnasella, me Nr. Rexh. Biznesi, 80118376 (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

TITULLI I KONTRATËS:

PERKRAHJA E BLEGËTORËVE ME MAKINA MJELËSE

Nr. I prokurimit	633 – 018 -6639-1-2-1/C149
I brendshëm	633-018-065-121

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është f në vijim nga ana e Kontraktuesit:

PERKRAHJA E BLEGËTORËVE ME MAKINA MJELËSE

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi i kësajë kontrate në total është: **19,942,00 €**
dhe me fjalë **Nëntëmbëdhjetë mijë/nëntëqind/katërdhjetë/dy euro**

2.2 Oferta financiare e kontraktorit, datë: **05.10. 2018.** është pjesë përbërëse e kontratës.

2.3. Vlera për njësi (një mjelëse) është: **169,00 € x 118 = 19.942,00 €**

2.4 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.5 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- Marrëveshja e kontratës;
- Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
- Plani për meaxhimin e kontratës

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cëkin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.




4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:

Komuna e Istogut

Për Kontraktorin:

NT "Rimida"

Emri:	Zizë Bujupaj	Emri:	Rrustem Hasani
Pozita:	Zyrtar Përgjegjës i prokurimit	Pozita:	<i>pa</i> Drejtore
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:		Data:	12. 11. 2018
Vula:		Vula:	

PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë Gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë: SHQIPE
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është- FILLIMI I furnizimeve DO TE JETË 3 DITË PAS NENSHKRIMIT TE KONTRATËS DHE DO TE PËRFUNDOJË ME 30.11.2018
	6.4	Data e Përfundimit është PAS RAPORIT TE MENAXHERIT TE KONTRATËS 30. Ditë kalendarike bazuar në planin dinamik të parashtruar nga kontraktori.
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është- Komuna Istog
Obligimet Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxhëri i Projektit është DREJTORI I DREJTORATIT PËR BUJQËSI apo ndonje zyrtar i percaktuar mirë vendim të veçantë i autorizuar nga personat përgjegjës.
Dëmet likuiduara	13.1	Norma e dëmeve të likuiduara është 0.25% PER ÇDO DITE TE VONUAR, ME FJIN E KONTRAKTORIT E ME SE LARTI DERI NE 10 % E VLERES SE NENSHKRUAR TE KONTRATES, NË AFAT VLEFISHMËRIJE PREJ 60 DITESH.
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve	15.1	Rreziqet dhe mbulimi nga sigurimi do të jenë: PËR TË GJITHA RREZIQET QE MUND TE SHKAKTOHEN GJATE EKZEKUTIMIT TE KONTRATES, PERGJEGJËSIA DO TE BIE MBI KONTRAKTORIN FURNITORIN
Parimet përgjithshme të pagesës	16.1	Orari i pagesës do të jetë: SIPAS KUSHTEVE TE PERGJITHSHME TE KONTRATËS- PAS KRYERJES SE FURNIZIMEVE
Kontrolli kualitetit	17.1	Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në vijim: MENAGJERI I KONTRATES DO TE PERCJELLË VAZHDIMISHT FURNIZIMET E MALLRAVE DHE DO TE RAPORTOJE OPER RRJEDHEN DHE PROGRESIN E KONTRATËS.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	PALET PËR ÇDO MOSMARRËVESHTJE QE MUND TE LIND GJATE EKZEKUTIMIT E KONTRATËS, DO TE PERPIQEN QE T'I ZGJEDHIN ME MARËVESHTJE NGA ZYRTARËT KOMUNAL- ORGANET KOMUNALE - DREJTORATI PERKATËS
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet GJYKATA THEMELORE - DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE EKONOMIKE - PRISHTINË.